EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Procesi i Riatdhesimit në Kosovë

Organizimi institucional, korniza ligjore, mësimet e nxjerra dhe sfidat që mbeten

Duke punuar drejt një
Kosovë stabile multietnike

Mbështetur nga:

FORMIN.FINLAND.FI
MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Autor: Laia Pau Romaní
Redaktor: Jérémie Zeitoun
Përkthyes: Gjergj Filipaj, Biljana Ivančević
Korrektimi gjuhësor: Paul Hickey, Besnik Kabashi, Ann Madsen, Arben Osmani

ECMI Kosova

ECMI Kosova është organizata joqeveritare kryesore e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike.

ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritare të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetit e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

www.ecmikosovo.org

info@ecmikosovo.org

Rruga "Nënë Tereza" Nr. 41, Apartamenti 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 (0)38 224 473

Rruga Çika Jovina Nr. 3, Kati I
38220 Mitrovicë e Veriut, Kosovë
Tel. +381 (0) 64 00 55 488 / +386 (0) 49 44 63 65

E drejta e autorit

© Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë. Dhjetor 2013. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdolloj mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi, apo çfarëdo mjeti/formë tjetër, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave *4*

Përmbledhje e përgjithshme *5*

Hyrje *7*

1. Qëllimet dhe Struktura 7
2. Qasja konceptuale 7
   - 2.1. Përkufizimi i kthimit dhe i të kthyerit 8
   - 2.2. Përkufizimi i riatdhesimit dhe të riatdhesuarve 8
3. Riatdhesimi në Kosovë 10
   - 3.1. Kontekstualizimi historik 11
   - 3.2. Një vështrim i vlerësuar 13

Kapitulli 1 - Korniza e Zbatimit: Instrumentet Politike dhe Mekanizmat Institucional *17*

1. Instrumentet Politike 18
   - 1.1. Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar 18
   - 1.2. Plani i veprimit: Implementimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar 19
   - 1.3. Rregullorja për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të riintegrimit 20
2. Mekanizmat institucional 23
   - 2.1. Institucionet qendrore 23
   - 2.2. Institucionet komunale 29

Kapitulli 2 – Vlerësimi i Kornizës së Zbatimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar: Problemi i Zbatimit të Ligjit dhe faktorët e ndërlidhur *32*

1. Mungesa e Ndërgjegjësimit 33
2. Mungesa e transparencës dhe koordinimi i pamjaftueshëm dhe bashkëpunimi mes institucioneve 34
3. Mbledhja e parregullt e të dhënave dhe koordinimi 35
4. Identifikimi joefikas apo i vonshëm i nevojave prioritare 36
5. Iniciativat e rralla të ndihmës 37
   - 5.1. Regjistrimi Civil 37
   - 5.2. Arsimi 37
   - 5.3. Shëndetësia 38
   - 5.4. Punësimi dhe Mirëqënia Sociale 38
   - 5.5. Strehimi 39

Konkluzionet *40*

Bibliografia *41*

Aneksi - Korniza Ligjore dhe Instrumentet Ndërkombëtare *43*

Lista e shkurtesave

KiE	Këshilli i Evropës
DSAM	Departamenti për shtetësi, azil dhe migracion
KE	Komisioni Europian
BE	Bashkimi Europian
IOM	Organizata ndërkombëtare për migrim
MKK	Ministria për komunitete dhe kthim
ZKP	Zyrat komunale të punësimit
MMPH	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
MASHT	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë
MF	Ministria e financave
MSh	Ministria e shëndetësisë
MPB	Ministria e punëve të brendshme
MAPL	Ministria e administrimit të pushtetit lokal
MPMS	Ministria e punës dhe mirëqenies sociale
ZKKK	Zyra Komunale për komunitete dhe kthim
NATO	Organizata e traktatit të atlantikut të veriut
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
ZR	Zyra për riintegrimin
UNDP	Programi për zhvillim i kombeve të bashkuara
UNHCR	Agjencia e kombeve të bashkuara për refugjatë
UNMIK	Misioni i administratës së përkohshme të kombeve të bashkuara në Kosovë
QAP	Qendrat e aftësimit profesional

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport dokumenton procesin e riatdhesimit dhe riintegrimit në Kosovë. Duke përfshirë riatdhesimin vullnetar, të detyruar, të asistuar dhe atë spontan. Gjatë viteve 1990, shumë persona u larguan për shkak të luftërave në ish-Jugosllavi dhe që prej pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, vendet e ndryshme pritëse kanë kërkuar që refugjatët dhe azilkërkuesit kosovarë të kthehen. **Prandaj është e nevojshme një kornizë e posaçme për të monitoruar procesin e riatdhesimit.** Për fat të keq, procesi i riatdhesimit është me të meta të dukshme dhe shumë persona po përballen me kushte shumë të pakënaqshme. Procesi i riintegrimit në Kosovë përbëhet nga tri fazat e mëposhtme: **ri-pranimit**, **pritjes** dhe **riintegrimit**. Personat e riatdhesuar shpesh nuk janë të vetëdijshëm për shërbimet e caktuara për shkak të mungesës së vetëdijes për procesin. Që nga viti 2012, janë ndërmarrë hapa për të rritur ndërgjegjësimin, megjithatë, ende ekzistojnë probleme në nivelin qendror dhe atë lokal. Komunikimi i kufizuar në mes të subjekteve të ndryshme gjithashtu pengon procesin duke ulur ndërgjegjësimin dhe duke kufizuar njohuritë e punonjësve të angazhuar në procesin e riatdhesimit.

Ka ende shumë çështje që pengojnë sistemin aktual. Për shembull, ekziston një ndërgjegjësim i kufizuar në lidhje me procesin e riatdhesimit, si dhe një mungesë e vullnetit politik për të nxitur ndryshimin. Mungesa e transparencës dhe koordinimit, së bashku me ofertën e kufizuar të ndihmave, gjithashtu paraqet probleme. Personat e riatdhesuar shpesh përballen me vështirësi pas kthimit. Ata që kanë jetuar jashtë vendit për një periudhë më të gjatë mund të përballen me **pengesa gjuhësore, çështje të pronësisë, probleme ekonomike dhe çështje të identitetit kulturor**. Kështu, është e domosdoshme që të projektohet një sistem i qartë dhe gjithashtu të shpërndahen informata në mënyrë adekuate. Çështjet me të cilat ndeshet procesi i riatdhesimit janë me interes të veçantë për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe grupet e tjera të margjinalizuara.

Ky raport trajton institucionet brenda qeverisë që ndihmojnë procesin e riatdhesimit në nivel lokal dhe qendror, si dhe instrumentet e miratuara politike, siç janë Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregullorja për menaxhimin e programit. Për më tepër, raporti analizon Menaxhimin e programit për riintegrim të miratuar në vitin 2013, gjë që shpjegon të drejtat, mundësitë dhe procedurat e ofruara për personat e riatdhesuar sipas legjislacionit të Kosovës, duke përfshirë edhe masat e ndihmës që kanë të bëjnë me shëndetësinë, arsimin, punësimin dhe strehimin.

Me gjithë progresin që është bërë, megjithatë mbetet të bëhet punë domethënëse për të siguruar që personat e riatdhesuar të kenë qasje në shërbimet e ofruara. Ky raport ka për qëllim të shërbejë si një instrument për të sqaruar procesin e riatdhesimit në Kosovë, shërbimet e ofruara për personat e riatdhesuar dhe përgjegjësitë që ka qeveria.

ECMI Kosova ka nxjerrë këto përfundime nga hulumtimet e saj dhe do të formulojë rekomandime mbi bazën e tyre. Është kritikuar **Kuadri i paqëndrueshëm rregullator**, megjithatë, instrumentet e reja pritet që të zbatohen në mënyrë të prerë për të siguruar një proces më efikas dhe ndikim më të mirë për përfituesit. **Kapaciteti i kufizuar i autoriteteve** gjithashtu ka ndikuar zbatimin. Për shembull, asnjë komunë, deri më tani, nuk ka bërë një vlerësim formal ose të ketë zhvilluar ndonjë program, strategji apo aktivitet që synon të zbatojë masat e kornizës së politikave në nivel komunal. Kjo kryesisht vjen si rezultat i ndarjes së paqartë të përgjegjësive në mes të pushtetit qendror dhe lokal.

Një faktor tjetër që pengon kornizën është fakti se shumë të riatdhesuar kanë shpresa të larta para riatdhesimit, duke i lënë personat e riatdhesuar të zhgënjyer me standardet që hasin pas kthimit. Për të përmirësuar këtë, **është thelbësore që të ofrohen udhërrëfyes dhe udhëzime në të gjitha nivelet** për të arritur njohuri më të mirë të përmbajtjes së kornizës ndërmjet institucioneve, në mënyrë që institucionet të jenë në gjendje të shpërndajnë informacionin e duhur. Kjo në fund të fundit do të përmirësojë ndihmën në dispozicion dhe do të rris ndërgjegjësimin në mesin e atyre që i qasen sistemit.

Për më tepër, kjo do t'i bëj shërbimet dhe procedurat më të arritshme dhe të kuptueshme për të gjithë. Aktualisht, nuk ekziston asnjë lidhje në mes të MPB-së, institucioni bartës i procesit të riatdhesimit, dhe sistemeve të tjera, të tilla si MKK-ja bartëse procesit të kthimit. Nëpërmjet komunikimit, këto institucione do të ishin në gjendje të shkëmbejnë konceptet për praktikat e mira, duke rritur njohuritë dhe efektivitetin. Për më tepër, një transparencë e rritur dhe një shkëmbim i informacionit midis nivelit lokal dhe qendror është i domosdoshëm për të promovuar efikasitetin. Disa çështje kyçe mbeten shqetësim për personat e riatdhesuar. Për shembull, regjistrimi civil dhe lëshimi i dokumenteve mund të jetë çështje problematike për personat e riatdhesuar. Përveç kësaj, braktisja e shkollës dhe normat e segregacionit apo veçimit në shkolla në mesin e fëmijëve të riatdhesuar janë jashtëzakonisht të larta, duke demonstruar nevojën jetike për ngritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me këtë situatë. **Rekomandohet që qeveria të zhvillojë projekte që gjenerojnë të ardhura për të favorizuar riintegrimin e qëndrueshëm** me shpresën e përmirësimit të procesit të riatdhesimit dhe rritjes së efikasitetit. Nëpërmjet transparencës më të madhe, bashkëpunimit dhe ndërgjegjësimit, procesi i riatdhesimit mund të bëhet më efikas.

Hyrje

1. Qëllimet dhe Struktura

Ky raport dokumenton procesin e riintegrimit dhe riatdhesimit në Kosovë. Kjo përfshin riatdhesimin vullnetar, të detyruar, të asistuar dhe atë spontan. Gjatë viteve 1990, shumë njerëz u larguan për shkak të luftërave në ish-Jugosllavi, dhe që prej pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, vende të ndryshme pritëse kanë kërkuar që refugjatët dhe azilkërkuesit të kthehen në Kosovë.

Ky raport trajton institucionet brenda qeverisë që e ndihmojnë procesin e riatdhesimit në nivel lokal dhe qendror, si dhe instrumentet e politikave të miratuara, siç janë Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregullorja për menaxhimin e programit. Për më tepër, raporti analizon Menaxhimin e programit për riintegrim të miratuar në vitin 2013, gjë që shpjegon të drejtat, mundësitë dhe procedurat e ofruara për personat e riatdhesuar nën legjislacionin e Kosovës, duke përfshirë edhe masat e ndihmave që kanë të bëjnë me shëndetësinë, arsimin, punësimin dhe strehimin.

Së fundi, raporti nxjerr përfundime dhe rekomandime që i adresohen nivelit qendror dhe palëve të interesuara në nivel lokal për të përmirësuar të gjithë procesin e riatdhesimit.

2. Qasja konceptuale

Para hyrjes në thelbin e këtij hulumtimi, është e rëndësishme të trajtohet dhe të sqarohet çfarë do të thotë riatdhesimi, cilat janë dallimet kryesore në mes të riatdhesimit dhe kthimit, dhe cilat kategori mund të krijohen gjatë përcaktimit të të dy koncepteve. Qasja e zakonshme konceptuale është e bazuar në terminologjinë e vendosur nga 2-dy organizatat kryesore ndërkombëtare të specializuara në këtë çështje: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe Komisioneri i Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR).[1]

[1] Kornizë e njëjtë konceptuale është përdorur nga autoritetet e Kosovës në zhvillimin e Planit të rishikuar të Strategjisë dhe Planit të veprimit.

2.1. Përkufizimi i kthimit dhe i të kthyerve

Një **i kthyer** është një individ i cili është kthyer dhe, në kuadrin ndërkombëtar, kjo i referohet gjerësisht aktit ose procesit të kthimit në vendin e individit apo komunitetit të origjinës.[2]

Akti **i kthimit** mund të bëhet në dy mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, mund të bëhet brenda kufijve territorialë të një vendi, siç është rasti i kthimit të personave të zhvendosur brenda vendit (PZhBV-e) dhe luftëtarëve të demobilizuar. Nga ana tjetër, akti i kthimit mund të bëhet nga një vend pritës në vendin e origjinës, siç është rasti me refugjatët, azilkërkuesit dhe shtetasit e kualifikuar.[3]

Për më tepër, ekzistojnë nën-kategori të kthimit të cilat përshkruajnë mënyrën e kthimit të aplikuar. Prandaj, kthimi mund të jetë vullnetar, i detyruar, i asistuar apo spontan.[4]

Së fundi, ekzistojnë nën-kategori të cilat përshkruajnë se kush merr pjesë në kthim. Kur i kthyeri është refugjat[5], ne e quajmë atë kthim, **riatdhesim.**[6]

2.2. Përkufizimi i riatdhesimit dhe të riatdhesuarve

Sipas asaj që është vendosur në pjesën e mëparshme, një **i riatdhesuar** është një refugjat në aktin e kthimit nga një vend pritës në vendin e tij/saj të origjinës; **Riatdhesimi** është e drejtë personale e një refugjati, një të burgosuri të luftës ose një të paraburgosuri civil.[7] Kthimi në vendin e tij/saj të shtetësisë

[2] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Fjalor i specializuar i termave, 2006, f.23
[3] Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalor për Migracionin, 2004, p.56
[4] *Ibidem*
[5] Në përputhje me Konventën për Statusin e Refugjatëve 1951 Nen 1A (2), e modifikuar nga Protokolli i vitit 1967, një refugjat është një person, i cili "për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të opinioneve politike, është jashtë vendit të shtetësisë së tij/saj dhe nuk është në gjendje ose për shkak të frikës, nuk dëshiron që të bjerë në mbrojtjen e atij vendi" . Përveç kësaj , duke iu referuar refugjatëve në një kontekst të riatdhesimit, ne kemi nevojë që të largohemi nga një konceptualizim më i gjerë, duke përfshirë në përkufizimin e refugjatit, konceptin e refugjatëve *de facto*. Siç është përcaktuar me Ligjin Ndërkombëtar të Migracionit: Fjalori për Migracionin, refugjatë *de facto* përcakton "personat që nuk janë njohur si refugjatë brenda kuptimit të Konventës së OKB-së lidhur me Statusin e Refugjatëve, 1951 dhe me Protokollin që ka të bëj me Statusin e Refugjatëve, 1967, dhe të cilët nuk janë në gjendje apo , për arsye të njohura si të vlefshme, nuk janë të gatshëm për t'u kthyer në vendin e shtetësisë së tyre, ose, në qoftë se ata nuk kanë shtetësi, në vendin e qëndrimit të tyre të zakonshëm", (Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), Ligji ndërkombëtar i Migracionit: Fjalori për Migracionin, 2004, faqe 17).
[6] Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalori për Migracionin, 2004, f. 55
[7] Në ligjin për konfliktet e armatosura ndërkombëtare, riatdhesimi gjithashtu përfshin detyrimin e autoritetit ndalues të lirojë personat si (ushtarët dhe civilët) dhe detyrën apo obligimin e vendit të origjinës për të marrë dhe/apo riatdhesuar shtetasit e vet në fund të armiqësive. Edhe nëse ky ligj traktat nuk përmban një rregull të përgjithshëm mbi këtë pikë, është edhe sot lehtësisht e pranueshme se riatdhesimi i të burgosurve të luftës dhe të paraburgosurve civilë që është në pajtim dhe/apo pëlqim në mënyrë të nënkuptuar nga palët e interesuara; (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalori për Migracionin, 2004, p. 55).

në kushte të caktuara është siguruar (dhe garantuar) me instrumente të ndryshme ndërkombëtare.[8] Në praktikë kjo nuk mund të përgjithësohet, megjithatë në parim, opsioni i riatdhesimit mbështetet mbi individin dhe vullnetin e tyre personal, jo mbi institucionin ndalues. Përveç kësaj, riatdhesimi si koncept gjithashtu vlen edhe për të dërguarit diplomatikë dhe zyrtarët ndërkombëtarë në kohë krizash ndërkombëtare si dhe për të huajt dhe emigrantët.[9] Në këtë drejtim, gjatë përkufizimit të riatdhesimit, ne mund të krijojmë dy nën-kategori në lidhje me mënyrën se si është kryer riatdhesimi, riatdhesimi vullnetar dhe riatdhesimi i detyruar. Nga njëra anë, ***riatdhesimi vullnetar*** i referohet aktit të kthimit në vendin e origjinës me siguri të lartë, me dinjitet, informim të plotë dhe me gatishmërinë dhe vullnetin e shprehur për tu kthyer lirisht.[10] Sipas nivelit të ndihmës së dhënë gjatë procesit, riatdhesimi vullnetar mund të jetë i organizuar, që do të thotë se mund të zhvillohet nën kujdesin e qeverive të interesuara dhe UNHCR-së, apo mund të jetë spontan, që do të thotë se refugjatët kthehen me mjetet e tyre me UNHCR-në dhe qeveritë që kanë pak ose nuk kanë fare përfshirje të drejtpërdrejtë në procesin e kthimit.[11]

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se disa të ashtu-quajtura 'riatdhesime vullnetare', veçanërisht ato që kanë ndodhur në mënyrë spontane, zakonisht korrespondojnë me kategorinë e ***riatdhesimit të detyruar***. Personat e prekur janë marrë me forcë nga shtëpitë e tyre në zyrat e policisë në mënyrë që të nënshkruajnë dokumente ku thuhet se ata do të kthehen vullnetarisht, dhe më pas ata janë dërguar në aeroport nga ku janë kthyer në vendin e tyre të origjinës.[12] Në vitet e fundit, të tilla riatdhesime "vullnetare" janë bërë metodë e zgjedhur nga pjesa më e madhe e vendeve pritëse të Europës Perëndimore. Refugjatë ose persona nën mbrojtje të përkohshme[13] janë të detyruar të kthehen në vendet e tyre të origjinës,[14] zakonisht në kushte jo të kënaqshme, duke përfshirë mungesën e sigurisë, ndihmës themelore dhe infrastrukturës për riintegrim.[15] Një person i riatdhesuar nga

[8] Instrumentet ndërkombëtare që parashikojnë dispozitat për kushtet specifike të ripranimit janë: Konventat e Gjenevës, 1949, dhe Protokollet, 1977, Rregulloret e respektimit të ligjeve dhe zakoneve të luftës në Tokë, e aneksuar në Konventën e Katërt të Hagës, 1907, instrumentet e të drejtave të njeriut si dhe ligjet e zakonshme ndërkombëtare.

[9] Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalor për Migracionin, 2004, f. 55

[10] *Ibidem,* faqe 69

[11] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Master Fjalor i termave, 2006, f. 23

[12] Human Rights Watch (HRW), Të drejtat e Zhvendosur: kthimet e detyruara të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve nga Evropa Perëndimore në Kosovë, 2010, f. 28

[13] *Mbrojtja e përkohshme* (MP) u prezantua nga shumë vende anëtare të BE-së si një masë afatshkurtër në kontekstin e konflikteve të armatosura që ndodhën në ish-territoret e Jugosllavisë gjatë viteve 1990. Mbrojtja e përkohshme është përdorur si një masë alternative apo zëvendësim i së drejtës për të kërkuar azil, masë individuale sipas Konventës së Refugjatëve të 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalori për Migracionin, 2004, faqe 64).

[14] Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë,* 2010, f. 16.

[15] Sipas Manualit të UNHCR-së për riatdhesimin dhe aktivitetet e riintegrimit, ndihma për riintegrimin nënkupton aktin për të marrë mbështetje për restaurimin e mbrojtjes kombëtare (pra, për të shmangur nevojën e mbrojtjes ndërkombëtare) dhe,

Gjermania, i intervistuar nga Amnesty International në Fushë Kosovë në qershor të vitit 2010, ka thënë: *"Mua më detyruan të nënshkruaj për një kthim vullnetar. Ata më kërcënuan se do të më merrnin gjatë natës dhe thjeshtë do të më kthenin me forcë. Kështu që u ktheva vullnetarisht*".[16]

Nga ana tjetër, ***riatdhesimi i detyrueshëm ose i pavullnetshëm*** i referohet aktit të kthimit në vendin e origjinës i detyruar nga vendi pritës duke krijuar rrethanat që lënë personat e prekur pa asnjë alternativë tjetër. Me fjalë të tjera, të riatdhesuarit me forcë janë persona pa status ligjor që kanë dështuar të përmbushin, ose nuk plotësojnë kushtet për të qëndruar në territorin e vendeve pritëse dhe, prandaj, janë detyruar të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Duke marrë parasysh se riatdhesimi është një e drejtë personale, as shteti i kombësisë dhe as shteti i vendbanimit të përkohshëm apo autoriteti ndalues nuk justifikohen në zbatimin e riatdhesimit kundër vullnetit të një personi të ligjshëm, qoftë refugjat apo rob i luftës. Në linjë me këtë, sipas ligjit bashkëkohor ndërkombëtar, të burgosurit e luftës ose refugjatët që refuzojnë riatdhesimin, veçanërisht nëse motivohen nga frika e përndjekjes politike në vendet e tyre, duhet të mbrohen nga dëbimi[17] dhe tu jepet, nëse është e mundur azil, i përkohshëm ose i përhershëm.[18]

3. Riatdhesimi në Kosovë

Duke adresuar çështjet konceptuale për sa i përket procesit të kthimit dhe riatdhesimit, dhe duke përcaktuar qasjen tonë ndaj riatdhesimit, ne tani do të vazhdojmë për të përcaktuar praktikën e procesit në kontekstin e Kosovës. Ky seksion ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë thelbësore historike dhe statistikore të praktikës aktuale të riatdhesimit në Kosovë, dhe të identifikojë aspektet kryesore që karakterizojnë zbatimin e tij.

---

përmes procesit të riintegrimit, mundësinë për të ruajtur një jetesë të qëndrueshme, qasje në shërbimet bazë dhe një riintegrim i plotë në komunitet dhe në vendin e origjinës; (Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Doracak për riatdhesimin dhe aktivitetet e riintegrimit, maj 2004, faqe 24.)

[16]Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë,* 2010, f. 16.

[17] Human Rights Watch (HRW), Të drejtat e të Zhvendosurve: Kthimet e detyruara të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve nga Evropa Perëndimore në Kosovë, 2010, faqe 33

[18] Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migracionit: Fjalor për Migracionin, 2004, f. 64.

3.1. Kontekstualizimi historik

Siç është përcaktuar *në Rregulloren për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të riintegrimit*[19]*,* një person i riatdhesuar është *'një kosovar i cili për shkak të mungesës së bazës ligjore për të qëndruar jashtë vendit, ka qenë i ripranuar në Kosovë'.*

Në fillim të viteve 1990, shumë nga ata të cilët tani po kthehen dhe po riatdhesohen në Kosovë, kanë lënë ose qenë larguar nga Kosova për shkak të shpërthimit të luftërave në Jugosllavi që atëherë ishte Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ).[20]Gjatë dhe pas luftës së vitit 1999 në Kosovë, mijëra njerëz të të gjitha përkatësive etnike ikën nga Kosova. Ata që kryesisht u preken nga pasoja e pas konfliktit përfshin serbët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Për më tepër, në vitin 2004 si pasojë e dhunës së vazhdueshme ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, anëtarë të grupeve të ndryshme të komuniteteve të Kosovës, u detyruan të largohen nga Kosova. Në këtë kontekst, ndërkohë që shumë serbë dhe romë u larguan për në Serbi, të tjerët kërkuan mbrojtje ndërkombëtare në vendet e Bashkimin Evropian (BE-së) dhe në vende të tjera të Këshillit të Evropës (KiE). Në këtë kontekst, shumicës së tyre u është lejuar të qëndrojnë në shtetet e Evropës Perëndimore, dhe disa kanë marrë edhe mbrojtje azili nën Konventën për Refugjatët të vitit 1951 dhe Protokollit të saj të vitit 1967, apo duke qenë refugjatë *de facto*,[21] por pa status ligjor, dhe u është ofruar mbrojtje e përkohshme sipas ligjeve vendore të vendeve pritëse.[22]

Në shkurt të 2008, Kosova në mënyrë të njëanshme shpalli pavarësinë e saj.[23] Më pas, vendet pritëse që kishin pranuar popullsinë e Kosovës kur territori ishte nën kërcënimin e luftës, filluan t'i bëjnë presion

[19]Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja nr. *20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimi I Programit mit të integrimit,* Shtator 2013, Kapitulli I Neni 2.

[20] Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë,* 2010, f. 5.

[21] Në përputhje me Konventën për Statusin e Refugjatëve 1951 Nen 1A (2), e modifikuar nga Protokolli i vitit 1967, një refugjat është një person, i cili "për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të opinioneve politike, është jashtë vendit të shtetësisë së tij/saj dhe nuk është në gjendje ose për shkak të frikës, nuk dëshiron që të bjerë në mbrojtjen e atij vendi" . Përveç kësaj , duke iu referuar refugjatëve në një kontekst të riatdhesimit, ne kemi nevojë që të largohemi nga një konceptualizim më i gjerë, duke përfshirë në përkufizimin e refugjatit, konceptin e refugjatëve *de facto*. Siç është përcaktuar me Ligjin Ndërkombëtar të Migracionit: Fjalori për Migracionin, refugjatë *de facto* përcakton "personat që nuk janë njohur si refugjatë brenda kuptimit të Konventës së OKB-së lidhur me Statusin e Refugjatëve, 1951 dhe me Protokollin që ka të bëj me Statusin e Refugjatëve, 1967, dhe të cilët nuk janë në gjendje apo , për arsye të njohura si të vlefshme, nuk janë të gatshëm për t'u kthyer në vendin e shtetësisë së tyre, ose, në qoftë se ata nuk kanë shtetësi, në vendin e qëndrimit të tyre të zakonshëm", (Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), Ligji ndërkombëtar i Migracionit: Fjalori për Migracionin, 2004, faqe 17).

[22] *fn*. 13

[23] Edhe pse shumica e të huajve u larguan nga vendi gjatë dhe pas vitit 1999, në kontekstin e konfliktit, është e rëndësishme që të mbajnë në mend se disa nga ata që u kthyen në Kosovë ishin larguar gjatë viteve të 80-ta si pasojë e vështirësive socio ekonomike. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i serbëve të riatdhesuar në Kosovë, siç është rasti në komunën e Parteshit, ikën nga Kosova në mes të viteve 2007 dhe 2008, si pasojë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

autoriteteve të Kosovës për të pranuar të kthyerit. Metoda kryesore e miratuar ishte që atyre tu pezullohet statusi ligjor dhe mbrojtja e përkohshme[24] për kosovarët që jetojnë jashtë vendit, duke i lënë ata pa asnjë opsion tjetër përveç opsionit të kthimit në Kosovë[25].

Para vitit 2008, institucionet e Kosovës kishin kompetenca shumë të kufizuara të ripranimit të refugjatëve. Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i themeluar nga Këshilli i Sigurimit në Rezolutën e saj 1244 (1999), u bë autoriteti kryesor përgjegjës në këtë drejtim[26] me një mandat për të ndihmuar sigurimin e kushteve për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës si dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin perëndimor. Në mes të qershorit dhe nëntorit të vitit 2008, një përpjekje shumë e madhe humanitare ka asistuar më shumë se 850,000 kosovarë që të kthehen në Kosovë për të filluar rindërtimin e jetës së tyre. Vetëm në vitin 2000, nga 82.000 persona që kishin kërkuar mbrojtje jashtë vendit janë kthyer nëpërmjet një riatdhesimi të organizuar deri në fund të shtatorit. Edhe pse pjesa më e madhe (mbi 73.000) u kthyen vullnetarisht në mënyrë që të mos përballen me dëbimin, më shumë se 9,000 persona janë kthyer me forcë.[27]

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, institucionet e Kosovës gradualisht filluan të marrin kontrollin e mëtejshëm të aktiviteteve të ripranimit dhe të riatdhesimit, dhe në nëntor të vitit 2008, qeveria e Kosovës filloi komunikimin e drejtpërdrejtë me vendet nikoqire mbi kërkesat e ripranimit dhe çështje të tjera të lidhura me riatdhesimin. Më 12 korrik 2010, Qeveria e Kosovës ka shpallur Ligjin për ripranim, i cili përcakton rregullat dhe procedurat e procesit të ripranimit në Kosovë.[28] Në këtë kontekst është e rëndësishme për të nxjerrë në pah rolin e IOM-it dhe UNHCR-së, të cilët, që të dyja, që nga viti 1999 kanë mbështetur UNMIK-un dhe qeverinë e Kosovës në asistimin e kthimit vullnetar, nëpërmjet të ashtuquajturit Programi për riatdhesimin vullnetar në Kosovë të IOM-it/UNHCR-së.[29]


Në pesë vitet e fundit, një numër i madh i njerëzve të cilët u larguan nga Kosova janë kthyer vullnetarisht ose janë detyruar të riatdhesohen në Kosovë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit të nënshkruar ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe vendeve pritëse. Prandaj, që nga nëntori

[24] fn., 13
[25] Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f. 2.
[26] Mandati i Misionit të Përkohshëm të Administratës së OKB-së në Kosovë (UNMIK), në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/Pages/about.aspx (shikuar së fundit më 26 korrik 2013).
[27] Misioni i Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK), Dokumenti i Politikave për riatdhesimin e shqiptarëve të Kosovës, Tetor 2000, Nr 2, f. 2.
[28] Qeveria e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-208 për Ripranim, 12 korrik 2010.
[29] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Përditësim për Krizën e Kosovës 1999-2000, në dispozicion në:: http://www.unhcr.org/3ae6b80f2c.html (së fundit shikuar më 26 korrik 2013).

i vitit 2008, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me disa vende të rajonit dhe të Evropës Perëndimore, duke përfshirë Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Republikën Çeke, Danimarkën, Francën, Gjermaninë, Luksemburgun, Malin e Zi, Holandën, Norvegjinë, Sllovenine dhe Zvicrën.[30]

3.2. Një vështrim i vlerësuar

Si rrjedhojë e konfliktit të armatosur dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës[31] kthimi i pjesëtarëve të popullatës shumicë dhe komuniteteve pakicë në Kosovë ka qenë i ngadaltë, por i vazhdueshëm gjatë viteve të fundit. Rrjedhimisht, në mes viteve 2008 dhe 2012, ka pasur rreth 14.096 kthime të organizuara vullnetare[32] dhe 12.284 kthime të detyruara.[33] Mes viteve 2010 dhe 2012, sipas të dhënave në dispozicion, ka pasur rreth 2,191 kthime të detyruara.[34] Mungesa e të dhënave në lidhje me kthimin e detyruar në mes të viteve 2008 dhe 2010 ndoshta rrjedh nga fakti se kthimet e detyruara tradicionalisht janë regjistruar si kthime vullnetare.[35]



	2008	2009	2010	2011	2012
Voluntary	2381	2779	4518	2966	1681
Forced	2550	2407	2910	2435	1753
Induced	0	0	1079	751	362

[30] Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, Vlerësimi i përparimit për sa i përket zbatimit të kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, shtator 2011, f. 4

[31] Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë,* 2010, f. 15.

[32] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2010. shifra E, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra D. 1.


[33] *Ibidem*

[34] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra D. 1.

[35] Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë, 2010,* f. 16.

Sa i përket riatdhesimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, UNHCR-ja vlerëson se që nga viti 2000, rreth 24.020 persona që i përkasin komuniteteve pakicë janë kthyer vullnetarisht apo riatdhesuar nga vendet ku kanë qenë të zhvendosur (persona që janë kthyer nga Serbia qendrore dhe nga brenda Kosovës) dhe nga vendet e rajonit (persona që janë kthyer nga Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, dhe vende të tjera të treta, kryesisht të Evropës perëndimore).[36]

Rrjedhimisht, në mes të viteve 2008 dhe 2012, nga 14.096 riatdhesime vullnetar, 6025 ishin riatdhesime vullnetare të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Në këtë kontekst, në mes të viteve 2008 dhe 2012, 2.259 serbë të Kosovës, 849 romë, 1,842 ashkali dhe egjiptianë, 230 boshnjakë, 543 goranë, 286 shqiptarë të Kosovës, 2 turq, 3 kroat dhe 11 malazezë janë riatdhesuar forcërisht apo detyrimisht në Kosovës.[37]



Sa i përket komunave kryesore pritëse, që nga viti 2000, 2,663 persona janë riatdhesuar në Mitrovicë, 3,474 në Prizren, 4343 në Gjilan, 6,081 në Pejë dhe 7,459 në Prishtinë.[38] Së fundi, duke marrë parasysh riatdhesimin vullnetar sipas moshës dhe gjinisë, mund të konstatojmë që riatdhesimet kanë prekur gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë. Përveç kësaj, shumica e të riatdhesuarve vullnetarë kanë qenë të

[36]Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra B. 1.
[37]*Ibidem*
[38]Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra B. 2

rriturit e moshës në mes 18 dhe 59 vjet, të pasuar nga fëmijët e moshës ndërmjet 5-17 vjeç dhe fëmijët nga 0-4 vjeç.[39]

Më në fund, për sa i përket riatdhesimit të detyrueshëm të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, sipas UNHCR-së, që nga viti 2008, 1,970 persona forcërisht të riatdhesuar u takojnë komuniteteve pakicë.[40] Rrjedhimisht, në mes të viteve 2008 dhe 2012[41], 197 serbë, 1,046 romë, 332 ashkali, 15 egjiptianë, 104 boshnjakë, 123 goranë, 114 shqiptarë dhe 25 turq janë riatdhesuar forcërisht në Kosovë.[42]



Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa pjesa më e madhe e ndihmës ndërkombëtare në fushën e riatdhesimit dhe/apo të riatdhesuarve ka për qëllim të ndihmojë të riatdhesuarit e kthyer vullnetarisht që vijnë nga Evropa Perëndimore, personat e riatdhesuar përmes një procesi të detyruar shpesh mbeten pa asnjë ndihmë, qoftë nga institucionet e Kosovës apo organizatat ndërkombëtare. Si rrjedhojë, kthimi dhe riintegrimi i personave të riatdhesuar forcërisht mbetet një nga sfidat më të lëna pas dore për qeverinë e Kosovës. Përveç kësaj, të riatdhesuarit vullnetarë ende përballen me probleme serioze të riintegrimit pas kthimit në vend, duke përfshirë problemet në fushat

[39] *Ibidem*, figure B. 9
[40] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra C. 3.1; Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra D. 2
[41] Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012, shifra C. 4
[42] Nuk janë gjetur të dhëna në dispozicion mbi komunitetin malazez dhe kroat të Kosovës.

kryesore si atë të regjistrimit civil, shëndetësisë, arsimit, punësimit, mirëqenies sociale dhe strehimit. Këto pengesa janë veçanërisht serioze për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve tjera të rrezikuara siç janë gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Kapitulli në vijim i këtij studimi ka për qëllim të përshkruajë procesin e riatdhesimit në Kosovë dhe për të përshkruar instrumentet që përbëjnë kuadrin e zbatimit të miratuar nga autoritetet e Kosovës, për të përfunduar dhe për të dhënë udhëzime për procesin e ripranimit dhe riintegrimit të personave të riatdhesuar në Kosovë.

Kapitulli 1 - Korniza e zbatimit: Instrumentet politike dhe mekanizmat institucional

Sa më gjatë që refugjatët kanë qenë jashtë vendeve të tyre të origjinës aq më e madhe ka qenë sfida e ruajtjes së identitetit të tyre kulturor. Barrierat gjuhësore, problemet ekonomike, procedurat e panjohura administrative dhe çështjet pronësore e përkeqësojnë këtë situatë akoma më shumë. Në këtë kontekst, një proces i mirë-strukturuar dhe funksional i riintegrimit është qenësor në mënyrë që të sigurohet një kthim i vërtetë dhe i qëndrueshëm.

Procesi i riatdhesimit në Kosovë përbëhet nga tre faza kryesore, përkatësisht ripranimit, pritjes dhe riintegrimit. Rrjedhimisht, procesi i riatdhesimit fillon me fazën e ripranimit, bazuar në marrëveshjen dypalëshe midis vendit pritës dhe vendit të origjinës. Pas këtij vendimi, organi dërgues dhe/apo shteti mikpritës kontakton institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës për të verifikuar origjinën ose shtetësinë e personit. Pas marrjes së konfirmimit për ripranim nga institucionet përkatëse të Kosovës, personi mund të kthehet. Pas kësaj faze të parë, deri te mbërritja e personit të riatdhesuar në aeroport, institucionet e Kosovës janë të obliguara të marrin personin, të vlerësojnë shëndetin e personit në fjalë, të ofrojnë informacionin tashmë ekzistues për nevojat e personit dhe t'i sigurojnë atij/asaj informacion mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre në lidhje me riintegrimin e tij/saj. Nëse personi në fjalë nuk është në gjendje për të arritur destinacionin e tij/saj të fundit në Kosovë në ditën e mbërritjes, institucionet e Kosovës, në përputhje me kuadrin institucional në fuqi, janë përgjegjëse për t'i siguruar atij/asaj strehim të përkohshëm për një periudhë deri në shtatë ditë. Për më tepër, institucionet e Kosovës do të aranzhojnë transportin e tij/saj deri në destinacionin përkatës, kurdo që të paraqitet nevoja. Në fund, sapo që personi i riatdhesuar është ripranuar dhe atij/asaj i është dhënë asistenca e parë pas arritjes së tij/saj në komunën e origjinës, institucionet komunale, departamentet përkatëse dhe zyrat ose qendrat e specializuara janë përgjegjëse për t'i siguruar personit ndihmën e nevojshme për riintegrim, duke filluar nga regjistrimi civil deri tek strehimi dhe qasja në shërbimet publike, duke përfshirë fushat e shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale.

Pas përshkrimit të plotë të procesit të riatdhesimit në Kosovë, në vazhdim do të identifikojmë secilin prej instrumenteve që përbëjnë politikën e kohëve të fundit dhe zhvillimet institucionale të qeverisë së Kosovës, të projektuar për të siguruar një përgjigje dhe për të koordinuar proceset e ripranimit, pranimit dhe riintegrimit të personave të riatdhesuar, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal.

1. Instrumentet Politike

Në mes viteve 2007 dhe 2008, institucionet e Kosovës gradualisht filluan të marrin kontrollin e mëtejmë të aktiviteteve të ripranimit dhe riatdhesimit. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës me ndihmën e UNMIK-ut, ka iniciuar zhvillimin e mekanizmave të veta politike, që kanë për qëllim përshkrimin dhe vendosjen apo përcaktimin e rregullave dhe të skemës për përkrahjen e ripranimit dhe riintegrimit për personat e riatdhesuar. Konventat ndërkombëtare, standardet e BE-së dhe legjislacioni ekzistues vendor janë themelet e këtyre instrumenteve.[43]

Në linjë me këtë, instrumentet kryesore politike të Kosovës, të miratuara për të ofruar ndihmë për personat e riatdhesuar janë: Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar, miratuar në vitin 2007 dhe rishikuar në vitin 2010, Plani i Veprimit 2010 për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, dhe Rregullorja 2012 mbi Menaxhimin e programit, organeve kompetente, procedurave dhe kriteret për ndihma për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

1.1. Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar[44]

Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar u arrit mes UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës në tetor të vitit 2007 dhe është rishikuar në vitin 2010.[45] Në bazë të këtij vlerësimi, në maj të vitit 2010, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,[46] e cila sipas autoriteteve të Kosovës vlen për *"personat me prejardhje nga Kosova të cilët kanë dështuar të përmbushin apo që tani e tutje nuk përmbushin kushtet përkatëse për të qëndruar në territoret e vendeve të tjera"*[47], dhe që janë larguar nga Kosova para 28 korrikut të vitit 2010.

Strategjia e rishikuar përcakton politikat, masat dhe kuadrin institucional për menaxhimin e procesit të pritjes dhe riintegrimit të personave të riatdhesuar. Rrjedhimisht, Strategjia përshkruan dhe përcakton rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe komunale – mekanizmave qeveritare siç janë ministritë përkatëse dhe zyrat komunale - në të gjithë fazat e procesit të pritjes dhe riintegrimit.[48] Për më tepër, Strategjia përcakton politikat, udhëzimet dhe rekomandimet që duhet të merren për të

[43]Shih Aneksin: Lista e dokumentacionit ligjor si dhe konventat që lidhen me riintegrimin e personave të riatdhesuar.
[44]Derisa po përpilonim këtë raport, Strategjia e re ishte duke u rishikuar. Strategjia e re e rishikuar pritet të publikohet në shtator 2013.
[45]Para vitit 2006, përgjegjësia për t'u marrë me riintegrimin e personave të riatdhesuar ka qenë e UNMIK-ut, UNHCR-së, IOM-it dhe organizatave të tjera.
[46]Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010.
[47]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010*,f.7.
[48]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f*. 32-35.

siguruar zgjidhje të qëndrueshme për personat e riatdhesuar në të gjitha aspektet e riintegrimit: Pritjes dhe/apo pranimit fillestar,[49] të ndihmës humanitare, të shërbimeve mjekësore pas mbërritjes, të transportit dhe akomodimit të përkohshëm, të riintegrimit ligjor dhe qasjes në dokumentet civile për personat e riatdhesuar,[50] qasjes në institucionet e kujdesit shëndetësor,[51] arsimimit,[52] punësimit,[53] mirëqenies sociale[54] dhe strehimit dhe të shërbimeve pronësore.[55] Në këtë drejtim, qëllimi kryesor i Strategjisë së rishikuar është që të mbështesë riintegrimin socio-ekonomik të personave të riatdhesuar duke lehtësuar qasjen në mundësitë e punësimit dhe skemat sociale në dispozicion. Për më tepër, Strategjia e rishikuar parashikon regjistrimin e personave të riatdhesuar në institucionet shëndetësore dhe marrjen e kartave të shëndetit.[56]

Në fund, një vëmendje e veçantë përmes politikave të përgjithshme - duke mos synuar në mënyrë specifike të riatdhesuarit – i kushtohet nevojave të grupeve të cenueshme,[57] përkatësisht komuniteteve jo-shumicë, viktimave të trafikimit, prindërve të vetëm, jetimëve, fëmijëve me nevoja të veçanta, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

1.2. Plani i veprimit: Implementimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar

Pas ratifikimit të Strategjisë së rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Qeveria e Kosovës emëroi një Grup pune për të hartuar një plan të veprimit, që synon të modeloj zbatimin e Strategjisë së rishikuar. 'Plani i veprimit: Implementimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar', u miratua nga Qeveria e Kosovës në tetor të vitit 2010.[58]

Plani i veprimit i Strategjisë së rishikuar parasheh që të ndërmerren aktivitete konkrete nga institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe komunal në lidhje me zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e migracionit, riintegrimit dhe riatdhesimit;[59] vlerësimin e ngritjes se kapaciteteve të burimeve institucionale dhe njerëzore;[60] vendosjen e një komunikimi institucional. Objektivat kryesore janë: krijimi i një baze të

[49] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 9-11.
[50] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 11-14.
[51] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 15-16.
[52] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 18-20.
[53] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 17-18.
[54] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 21-24.
[55] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 28-31.
[56] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 16.
[57] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f.* 24-28.
[58] Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i veprimit: zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010.
[59] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f.* 5-6.
[60] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f.* 7-9.

dhënash të përbashkët dhe një strukture për ndarjen e informacionit[61]; ofrimi i shërbimeve në fushat e identifikuara nga Strategjia e rishikuar, brenda afateve të përcaktuara kohore[62]; dhe arritja e një riintegrimi të qëndrueshëm.[63] Për më tepër, plani i veprimit parashikon ngritjen e një fondi për riintegrim[64] dhe siguron mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit në lidhje me zbatimin e Strategjisë së rishikuar.[65]

1.3. Rregullorja për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të riintegrimit

Rregullorja për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të riintegrimit[66] është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në shtator të vitit 2013, si zëvendësim për Rregulloren për menaxhim të programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret për përfitim për riintegrimin e personave të riatdhesuar[67] e miratuar në tetor të vitit 2012.

Rregullorja aktuale është strukturuar në gjashtë kapituj që kanë për qëllim të vendosin synimet e fushëveprimit të rregullores dhe për të vendosur të drejtat dhe mundësitë në dispozicion për personat e riatdhesuar në lidhje me: ndihmën pas mbërritjes, paketat ndihmëse për sa i përket shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe strehimit, për të përcaktuar përgjegjësitë e organeve kompetente qendrore dhe komunale, krijimin e kritereve bazë të përshtatshmërisë për programin e riintegrimit, dhe përshkrimin e programit të menaxhimit për fondin e riintegrimit. Rrjedhimisht, kjo rregullore është e një rëndësie vendimtare në sigurimin e të drejtave të personave të riatdhesuar.

- **Ndihma pas mbërritjes në Kosovë**

Sipas rregullores, personat e riatdhesuar duhet të përfitojnë transport të organizuar nga pika e mbërritjes deri në vendin e destinacionit.[68] Zyra për riintegrim së bashku me zyrën e pritjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) e cila ndodhet në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës është përgjegjëse për organizimin e pritjes së personave të riatdhesuar në Aeroportin e Prishtinës dhe në

[61] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f*. 10-11.
[62] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f*. 12-13.
[63] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f*. 14-18.
[64] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f*. 19-23.
[65] *Plani i veprimit: Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010, f*. 24-25.
[66] Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 20/2013 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të riintegrimit, shtator 2013.
[67] Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 10/2012 për Menaxhimin e programit, organeve kompetente, procedurave dhe kritereve për përfitimet për riintegrimin dhe riatdhesimin, tetor 2012.
[68] Rregullorja Nr. 20/2013, neni 6 (6.2)

vendkalimet e tjera kufitare të Republikës së Kosovës. Me të arritur në Kosovë, Zyra për riintegrim[69] është përgjegjëse për informimin[70] e personave të riatdhesuar mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në programet për riintegrim, dhe gjithashtu është përgjegjëse për sigurimin e transportit të këtyre personave deri në vendet e destinacionit të tyre.[71]

- **Paketat e ndihmës**

Zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) është përgjegjëse për identifikimin e nevojave të personave të riatdhesuar në kuadër të komunës përkatëse, dhe është përgjegjëse për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve mbi aplikimet dhe kërkesat e personave të riatdhesuar për: ushqim dhe artikuj higjienik, strehimi; ndihmë mjekësore, ndihmë materiale, asistencë në orendi dhe pajisje shtëpiake, dhe ndihmë për nevojat gjatë stinës së dimrit.[72]

Rregullorja garanton të drejtën për një paketë ndihme dhe/apo asistence ushqimore dhe me artikuj higjienik për një periudhë prej 6-gjashtë muajsh[73] për personat e riatdhesuar me kushte të vështira socio-ekonomike që kanë nevojë për këtë ndihmë. Ato familje që fitojnë të drejtën për strehim të përkohshëm deri në 7-shtatë ditë kanë të drejtë të përfitojnë automatikisht paketën ndihmëse.[74] Ndihma ushqimore është e caktuar për person dhe ka fleksibilitet në qoftë se kërkohet më shumë për arsye shëndetësore.

Një mundësi e vetme për ndihmë në orendi deri në 2,000€ (1,000€ për individë) është siguruar për personat e riatdhesuar që nuk kanë pasur orendi të mjaftueshme.[75] Paketa e harmonizuar e ndihmës për orendi ofron, për shembull, një frigorifer për familje, deri në katër shtretër dhe një lavaman kuzhine për familje[76]. Në mënyrë të ngjashme, paketat e ndihmës materiale përfshijnë, për shembull, një batanije për çdo person, që ndryshon sipas madhësisë së familjes dhe janë të përshtatshme për nevojat e veçanta të grave dhe fëmijëve të vegjël domethënë peshqirë sanitarë ose pelena për foshnje.[77] Ndihma për nevojat gjatë stinës së dimrit është e garantuar për familjet e riatdhesuara bazuar në kushtet e vështira socio-ekonomike për ç'shkak ata nuk mund të sigurojnë karburantin vetë.[78]

[69]Shih seksionin B, 1. 2
[70]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 5
[71]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 6.1
[72]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 8
[73]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 8.5
[74]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 8.3
[75]Rregullorja Nr. 20/2013, neni 10.2
[76]Rregullorja Nr. 20/2013, Shtojca C
[77]Rregullorja Nr. 20/2013, Shtojca C
[78] Rregullorja Nr. 20/2013, neni 8.6

Ekziston gjithashtu një mundësi për ndihmë në rastet ad-hoc që do të ofrohet kur është e nevojshme, pas vlerësimit të autoriteteve përkatëse komunale dhe përmes ndërveprimit me palët përkatëse.[79]

- **Shëndetësia**

Personat e riatdhesuar, me të mbërritur në vend kanë të drejtë për ndihmën emergjente mjekësore, gjithnjë nëse u nevojitet.[80]Në bazë të kritereve për përfitim emergjent, të riatdhesuarit pas mbërritjes, gjithashtu mund ti qasen trajtimit mjekësor dhe mjekimit.[81]Ndihma mjekësore, trajtimi i veçantë siç janë trajtimet psikike-sociale dhe pagesa e shpenzimeve për barna jo të zakonshme mund të ofrohen për një periudhë prej 6 muajsh me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj të tjerë.[82] Megjithatë ndihma mjekësore i nënshtrohet kritereve[83] të përshtatshmërisë dhe nuk garantohet në masë të gjerë.

- **Arsimi**

Të gjithë fëmijët e riatdhesuar kanë të drejtë që të kenë të njëjtin arsimim dhe të drejtat e barabarta si nxënësit e tjerë në sistemin arsimor të Kosovës.[84] Rregullorja përcakton se në rast nevoje për fëmijët e riatdhesuar duhet të sigurohen kurse të gjuhës.[85] ZKKK-ja është përgjegjëse që para regjistrimit, në komunën përkatëse, të bëj vlerësimin mbi nevojën për kurse shtesë të gjuhës dhe të lehtësoj qasjen në arsim.[86] Në mungesë të dokumenteve, nxënësve të riatdhesuar u lejohet që të ndjekin mësimin në shkollë me kusht që ti sjellin dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur.[87]

- **Punësimi**

Rregullorja parashikon trajnim profesional,[88]asistencë për punësim [89], ndihmë për vetë-punësim dhe për nisje të biznesit.[90] Trajnim profesional për personat e riatdhesuar që i plotësojnë kriteret themelore të përshtatshmërisë, të cilët sipas organeve kompetente,vlerësohen se mund t'i rrisin mundësitë e punësimit të qëndrueshëm.[91] Rregullorja përcakton që ZKKK-ja është përgjegjëse për identifikimin e mundësive për ofrimin e trajnimeve profesionale dhe qasje në tregun e punës. Të gjithë personat e

[79] Rregullorja Nr. 20/2013, neni 11
[80] Rregullorja nr. 20/2013, Nenet 6.1 dhe 9.1
[81] Rregullorja nr . 20/2013, Neni 9.1
[82] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 9.4
[83]Rregullorja nr. 20/2013, Neni 9.3
[84] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 14.1
[85] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 14.2
[86]Rregullorja nr. 20/2013, Neni 14.2
[87] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 14.3
[88]Rregullorja nr. 20/2013, Neni 15
[89]Rregullorja nr. 20/2013, Neni 16
[90] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 17
[91] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 15.2

riatdhesuar që i plotësojnë kriteret bazë, e që nuk kanë përfituar nga projektet e tjera të gjenerimit të të ardhurave, kanë të drejtë që të hyjnë në programin e projekteve të gjenerimit të të ardhurave.[92]Aplikantët duhet të prezantojnë një certifikatë biznesi, një plan biznesi vlera e të cilit nuk i tejkalon 2000 euro,[93] dhe dëshmi për trajnimin profesional për zhvillimin e planit përkatës të biznesit, së bashku me formularin e aplikimit dhe dokumentet e rëndësishme përkatëse.[94]Së fundi, Zyra komunale e punësimit (ZKP) dhe Qendrat e aftësimit profesional (QAP) janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin periodik të zbatimit të planit përkatës të biznesit.[95]

- **Strehimi**

Rregullorja parashikon që personat e riatdhesuar (me të mbërritur) kanë të drejtë për strehim të përkohshëm në kohëzgjatje deri në shtatë ditë.[96]Për më tepër personat e riatdhesuar kanë të drejtë në një skemë të akomodimit nëpërmjet një skeme shtesë të tregut të qiramarrjes, për një periudhë gjashtë-6 mujore me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj të tjerë,[97] apo dymbëdhjetë muaj në raste të jashtëzakonshme.[98] Rregullorja gjithashtu ofron mundësinë e rinovimit ose të rindërtimit të shtëpive.[99] Duke i njohur instrumentet kryesore të politikës, seksioni i mëposhtëm ka për qëllim që t'i përshkruaj dhe t'i analizoj mekanizmat kryesor institucional, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, të projektuar për të koordinuar dhe për ti përkthyer në praktikë masat e parashikuara nga Strategjia e riintegrimit dhe Planit të saj të veprimit.

2. Mekanizmat institucional

Duke iu referuar mekanizmave institucional që kanë një rol në procesin e ripranimit dhe të riintegrimit të personave të riatdhesuar në Kosovë, si institucionet qendrore ashtu ato të nivelit komunal kanë role të rëndësishme. Në këtë seksion ne i paraqesim dhe i analizojmë institucionet më të rëndësishme.

2.1. Institucionet qendrore

Me qëllim të zbatimit të kornizës së përshkruar politike dhe të ofrimit të ndihmës së qëndrueshme dhe cilësore për riintegrim, disa institucione qendrore qeveritare luajnë një rol qendror dhe kanë

[92] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 17.3
[93]Rregullorja nr.. 20/2013, Neni 17.3
[94] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 17.2
[95]Rregullorja nr. 20/2013, Neni 17.4
[96] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 6.7
[97] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 7
[98] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 7.4
[99] Rregullorja nr. 20/2013, Neni 13

përgjegjësinë për të koordinuar nga afër, të mbikëqyrin dhe monitorojnë masat dhe aktivitetet e ndryshme të cilat e përbëjnë procesin e riatdhesimit, në fushat kyçe të regjistrimit civil, shëndetësisë, arsimit, punësimit, mirëqenies sociale dhe strehimit.

Ky seksion do të analizoj dhe ti përshkruaj përgjegjësitë kryesore të institucioneve qendrore që janë përgjegjëse për zbatimin dhe financimin e politikave të miratuara të riintegrimit, dhe të veprimeve të ndërlidhura (1.1), koordinimin dhe bashkëpunimin në mes institucioneve qendrore dhe atyre lokale (1.2), dhe rolin e secilës nga ministritë që kanë mandat për të siguruar kushtet elementare dhe zbatimin e proceseve të ripranimit, pritjes dhe riintegrimit (1.3).

- **Fondi qendror i riintegrimit**

Në përputhje me Planin e veprimit Fondi qendror i riintegrimit është themeluar në maj 2010 [100]me vendim të Kryeministrit me qëllim të shpërndarjes së fondeve buxhetore për të mbështetur zbatimin e masave të përshkruara nga Strategjia e rishikuar. Fondi synon që personave të riatdhesuar që kanë nevojë t'ju siguroj ndihmë të drejtpërdrejtë humanitare, transport, strehim të përkohshëm, ushqim dhe mjete higjienike, si dhe i ndihmon ata lidhur me akomodimin dhe ri-integrimin social-ekonomik.[101]

Përputhshmërish, alokimi i fondeve të përshtatshme është thelbësor me qëllim të garantimit që mbrojtja e ofruar përmes Strategjisë së rishikuar dhe Planit përkatës të veprimit është zbatuar në mënyrë efektive. Organi përgjegjës për administrimin e Fondit të riatdhesimit është Bordi koordinues ndërministror, që është përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për ndihmë të të riatdhesuarve.[102]

- **Bordi koordinues ndërministror**

Bordi koordinues ndërministror është themeluar nga qeveria në prill 2010[103], në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si një bord ekzekutiv përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kornizës së politikave të përshkruara, për pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë.[104] Bordi ekzekutiv përbëhet prej përfaqësuesve të ministrive përkatëse: Ministria e punëve të brendshme

[100]Vendimi i qeverisë nr. 4/126, 26 maj 2010

[101] Sipas qeverisë në vitin 2010 fondi i ndarë ka qenë 500.000 Euro, dhe në vitin 2011 ka qenë 3.4 milion (Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSCE) – Misioni në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, shtator 2011, f. 7*)

[102]*Plani i veprimit: Implementimi i strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* tetor 2010, faqet. 20-22

[103]Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 7/123, 30 prill 2010

[104]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, shtator 2011, f.* 5.

(MPB), Ministria e administrimit të pushtetit lokal (MAPL) , Ministria e shëndetësisë (MSh), Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MAShT), Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor (MMPH), një përfaqësues nga Ministria e financave (MF) dhe përfaqësues të Komisionit Europian (KE), Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatë (UNHCR) dhe Organizata ndërkombëtare për migracion (IOM) e cila merr pjesë në kapacitetin këshillëdhënës.[105]

Aktivitetet kryesore të bordit ekzekutiv janë:

- Menaxhimi i buxhetit për zbatim, të ndarë në fondin e riatdhesimit;
- Koordinimi i punës mes ministrive përkatëse dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet fushave të përgjegjësisë mes institucioneve qendrore dhe atyre komunale;
- Mbikëqyrja dhe koordinimi i zbatimit të Strategjisë së rishikuar dhe Planit të veprimit;
- Sigurimi i shpërndarjes efektive të informatave mes institucioneve qendrore dhe atyre komunale (ministritë dhe komunat), si dhe në mes të institucioneve dhe bamirësve të mundshëm;
- Promovimi i mbështetjes së dhënë nga donatorët potencial dhe aktorët aktivë në fushën e riintegrimit, koordinimit të strategjive qeveritare në nivel qendror dhe komunal; koordinimin e strategjive qeveritare në nivel qendror dhe komunal; dhe
- Raportimin në qeveri për të arriturat dhe sfidat që lidhen me riatdhesimin në Kosovë.[106]

Departamenti për riintegrimin e personave të riatdhesuar (DRRP), ish-Zyra për riintegrim është përgjegjëse për koordinimin dhe trajnimin e zyrtarëve komunal, përpunimin e kërkesave për financim për riintegrim para bordit ekzekutiv dhe mbajtjen e kontaktit me të riatdhesuarit. Veçmas kësaj zyra gjithashtu është përgjegjëse për ekipin e monitorimit në aeroport i cili mbledhë të dhënat përkatëse mbi të riatdhesuarit e mbërritur dhe që u siguron atyre ndihmë bazike nëse me të mbërritur kanë nevojë për të.[107]

[105]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 34
[106]*Ibidem*
[107]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011, f. 6

Sekretariati i koordinon aktivitetet e institucioneve, i jep rekomandime bordit ekzekutiv dhe ndihmon në çështjet administrative që kanë të bëjnë me kërkesat e personave të riatdhesuar për të përfituar nga ndihma në dispozicion përmes Fondit të riatdhesuarve.[108]

- **Ministritë me rëndësi**

Vijon një listë dhe përshkrim i shkurtër i roleve dhe përgjegjësive të ministrive kryesore me rëndësi.

[108] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010, f. 34*

EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO



Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Mandati i MPB-së është që të zhvilloj, zbatoj dhe monitorio politikat dhe legjislacionin në fushën e sigurisë dhe të punëve të brendshme.

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar MPB-ja, përmes Departamentit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë, luan një rol vendimtar koordinues ndërmjet ministrive përkatëse dhe institucioneve komunale.
- Për më tepër, MPB-ja është përgjegjëse për mbërritjen dhe për hapat e regjistrimit civil të procesit të riatdhesimit.
- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion është në krye të procedurave të ripranimit, negocimit dhe zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit, si dhe e vlerëson origjinën e personave të shpallur për ripranim.
- Agjencia për Regjistrim Civil do të zhvilloj, zbatoj dhe monitoroj politikat qeveritare për regjistrimin, gjendjen civile dhe dokumentacionin civil, si dhe do të koordinoj Qendrat komunale për regjistrim dhe Regjistrimin civil.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Detyrat e MAPL-së janë që të mbështesë dhe të avancojë qeverisjen lokale dhe në bashkëpunim me komunat të punoj, në mënyrë që të ofroj shërbime të plota dhe të përgjegjshme për popullatën e secilit rajon

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar MAPL-ja është përgjegjëse për koordinimin dhe sigurimin e udhëzimeve për komunat mbi zbatimin e strategjisë së rishikuar.
- Veçmas kësaj, MAPL-ja është përgjegjëse për mbështetjen e institucioneve lokale në zhvillimin e projekteve të riatdhesimit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

MPMS-ja është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit të punës dhe mirëqenies sociale

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar, mandati i MPMS-së kryesisht fokusohet në mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave.
- MPMS-ja gjithashtu është përgjegjëse për koordinimin dhe dhënien e ndihmës themelore në fusha të tilla si strehimi dhe transporti.
- Veçmas kësaj, MPMS-ja punon për të mbështetur dhe për të përmirësuar riintegrimin social-ekonomik dhe zhvillimin e personave të riatdhesuar.

Ministria e Arsmit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)

Misioni MAShT-it është për të hartuar, monitoruar dhe zbatuar politikat dhe legjislacionin për zhvillimin e një sistemi arsimor të mirë-përhapur, efikas dhe shumetnik .

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar, puna e MAShT-it fokusohet në sigurimin që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e riatdhesuar të riintegrohen në mënyrë të përshtatshme në sistemin e arsimit.
- Në këtë kontekst, MAShT punon për të siguruar që ata të marrin informatat e nevojshme për mundësitë në dispozicion të arsimimit dhe qasjes në programe të veçanta të riintegrimit, sipas nevojave të tyre dhe përmes orëve shtesë dhe trajnimit gjuhësor.

Ministria e Shëndetësisë (MSh)

Në mandatin e MSh-së bën pjesë promovimi, koordinimi dhe zbatimi i aktiviteteve të synuara për të ndërtuar një sistem koherent dhe efikas të kujdesit shëndetësor

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar, MSh-ja është përgjegjëse për mbështetjen e integrimit dhe qasje të papenguar të personave të riatdhesuar në shërbimet e sistemit të kujdesit shëndetësor.
- Gjithashtu, MSh-ja, në mesin e ministrive të tjera relevante, është përgjegjëse për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave shëndetësore të personave të riatdhesuar.
- Së fundi, MSh-ja u ofron ndihmë të menjëhershme personave të riatdhesuar pas mbërritjes dhe në strehimoret e përkohshme.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

MMPH-ja është përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në lidhje me menaxhimin e mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor dhe të strehimit.

- Në kontekstin e riintegrimit të personave të riatdhesuar, MMPH-ja, së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe në bashkëpunim me ministritë tjera përkatëse, është përgjegjëse për të ndihmuar dhe mbështetur përpjekjet për të gjetur dhe të siguruar strehim të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar.

2.2. Institucionet komunale

Si përfaqësues vendor (përfaqësuesit) të autoriteteve qeveritare, komunat luajnë rol thelbësor në zbatimin e legjislacionit, politikave dhe praktikave të krijuara për të përmirësuar dhe për të promovuar qasje të barabartë në shërbime, për të gjithë anëtarët e shoqërisë si dhe duke siguruar kujdes të veçantë ndaj nevojave dhe sfidave që i kanë grupet e cenueshme.

Prandaj komunat kryejnë një detyrë qendrore në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të rishikuar të veprimit, që synon sigurimin e kushteve të qëndrueshme për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Përkatësisht komunat kanë për qëllim që të punojnë së bashku në marrëveshje me institucionet e përshkruara të nivelit qendror, me qëllim të përparimit të riintegrimit dhe të dhënies ndihmë personave të riatdhesuar në fushat e regjistrimit civil, shëndetësisë, arsimit, punësimit, kujdesit social dhe strehimit. Në këtë seksion ne paraqesim instrumentet komunale, të krijuara për riintegrimin e personave të riatdhesuar pas mbërritjes dhe vendosjen së tyre.

- **Autoritetet komunale**

Udhëheqja komunale përfaqësohet nga kryetari dhe zëvendëskryetari i komunës. Kryetari dhe zëvendëskryetari i komunës janë personat kryesorë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit dhe politikave qeveritare, duke përfshirë këtu çdo strategji dhe plan të veprimit që ka të bëj me komunitetet, me të riatdhesuarit dhe ri-integrimin.

Në kontekstin e proceseve të kthimit, ripranimit dhe riintegrimit të riatdhesuarve, ata e luajnë rolin e mbikëqyrjes dhe monitorimit të zbatimit të masave të përgjithshme ekzistuese.[109]Në këtë pozitë, instrumenti i udhëheqësisë komunale së bashku me MAPL-në, duhet të siguroj dhe të lehtësoj koordinimin, dialogun dhe bashkëpunimin mes institucioneve të rëndësishme qendrore komunale, departamentet qendrore dhe zyrat. Veçmas kësaj kryetari i komunës ka për detyrë që të administrojë buxhetin komunal të riatdhesimit – i vendosur në nivel qendror në fondin e përshkruar më parë të riintegrimit - dhe për të raportuar te qeveria mbi zhvillimin e arritur në këtë fushë.[110]

[109]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Broshurë për zyrtarët komunalë mbi pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar,* dhjetor 2010, f. 36

[110]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 33

- **Kuvendi Komunal**

Është organi më i lartë përfaqësues i komunës dhe është përgjegjës për miratimin e akteve, rregullave të procedurës dhe të rregulloreve komunale, si dhe për miratimin e buxhetit komunal dhe planet e investimeve të komunës siç janë ato që lidhen me fondin e shpërndarë të riatdhesimit.[111] Për më tepër, kuvendi komunal duhet të lehtësojë punën e krijimit të një komiteti për komunitete, i cili përbëhet nga anëtarë të kuvendit prej të gjitha komuniteteve të pranishme në komunë. Është kompetent për të shqyrtuar projekt-rekomandimet dhe përputhjen e tyre me praktikat komunale që synojnë sigurimin e mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të komuniteteve, duke përfshirë edhe personat e riatdhesuar.[112]

- **Zyrat komunale për komunitete dhe kthim**

Rregullorja për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim [113] është miratuar në gusht 2010, duke e themeluar këtë institucion si një instrument të detyrueshëm komunal.[114] Përshkrimet e punës dhe termat e referencës për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK-të) janë miratuar në prill të vitit 2011.[115] Sipas rregullores mbi ZKKK-të komunat kanë për detyrë që të ndajnë burime të nevojshme financiare dhe të sigurojnë mbështetje logjistike me qëllim të ndërtimit dhe të lehtësimit të punës së ZKKK-ve.[116] Mandati i ZKKK-ve është që të sigurojë një kornizë të përshtatshme administrative me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, duke përfshirë të zhvendosurit, të rikthyerit dhe të riatdhesuarit. Gjithashtu të siguroj qasje të barabartë në shërbimet dhe të kontribuoj për një kthim të qëndrueshëm dhe për riintegrim. Kjo mund të bëhet duke vlerësuar nevojat e tyre, përmes vizitave në terren, promovimit të vetëdijesimit mbi masat ekzistuese, në mesin e zyrtarëve, komuniteteve, të zhvendosurve dhe refugjatëve të kthyer, dhe duke zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar projekte dhe aktivitete.[117] ZKKK-ja është përgjegjëse për pranimin dhe identifikimin e aplikacioneve të personave të

[111]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 32
[112]Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) – Misioni në Kosovë, *Broshurë për zyrtarët komunalë mbi pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar,* dhjetor 2010, f. 27
[113]Rregullorja e qeverisë nr. 02/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, e miratuar më 12 gusht 2010 dhe që ka hyrë në fuqi më 27 gusht 2010.
[114]Zyra Komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) i zëvendëson strukturat e mëparshme komunale të kësaj fushe, të njohura si ish- Zyra Komunale për komunitete dhe ish-zyrtari komunal për kthim.
[115]*Termat e referencës për Zyrat Komunale për komunitete dhe kthim*. Aprovuar nga Grupi punues ndërministror prill 2011.
[116]Rregullorja Nr. 02/2010, Neni 10.1
[117]Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) – Misioni në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011, f.8

riatdhesuar dhe orientimin e tyre kah organi që i merr vendimet.[118] Për më tepër ZKKK-ja ndihmon në zbatimin e vendimeve të marra nga ana e MKK-së dhe CCR-ja.[119] Gjatë koordinimit me aktorë rajonalë dhe ata lokalë ZKKK-ja gjithashtu shpërndan informata lidhur me shërbimet e ofruara për personat e riatdhesuar si dhe mbledh informacion për ta regjistruar në bazën e të dhënave.[120]

- **Komisioni komunal për riintegrim**

Komisioni komunal për riintegrim është organ vendimmarrës i formuar në nivel lokal nga kryetari i çdo komune.[121] Komisionet komunale për riintegrim përbëhen nga përfaqësues të departamenteve të ndryshme, siç janë ai i arsimit, shëndetësisë, punës dhe punësimit.[122] Komisioni i merr në konsideratë aplikacionet që ndërlidhen me pakot e ndihmës për personat e riatdhesuar. Pas pranimit të aplikacioneve vendimet duhet të merren sa më shpejt që të jetë e mundur, maksimalisht brenda shtatë ditësh, kurse kërkuesi do të njoftohet brenda dy ditëve nga momenti i marrjes së vendimit.[123] Komisioni gjithashtu shqyrton nevojat e personave të riatdhesuar në lidhje me *"qasjen në regjistrin e gjendjes civile, lëshimin e dokumenteve civile, arsimin dhe regjistrimin në shkollë, në rast nevoje trajtimin psiko-social dhe asistencën sociale, strehimin, dhe rregullimin e dokumentacionit kadastral*." [124] Meqë korniza e zbatimit dhe përmbajtja, roli dhe përgjegjësitë e masave dhe mekanizmave që i përfshin ajo përshkruhen dhe studiohen në hollësi, është e rëndësishme që të vazhdohet në vlerësimin e zbatimit të saj. Seksioni në vijim synon që të vlerësoj zhvillimin dhe ndikimin e kësaj kornize të zbatimit.

[118]Rregullorja QRK Nr. 20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, neni 24.
[119]Rregullorja QRK Nr. 20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, neni 24..
[120]Rregullorja QRK Nr. 20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, neni 24.
[121]Rregullorja QRK Nr. 20/2013 mbi Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, neni 25
[122]ibid
[123]ibid
[124]ibid

Kapitulli 2 – Vlerësimi i Kornizës së Zbatimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar: Problemi i Zbatimit të Ligjit dhe faktorët e ndërlidhur

Duke u bazuar në analizën e zhvilluar në gjithë kapitullin e mëparshëm, çdo gjë tregon se në teori instrumentet e miratuara të politikës punuese dhe mekanizmat institucionalë, që synojnë të sigurojnë mbështetje dhe të ndihmojnë riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë, janë relativisht të kompletuar dhe të strukturuar mirë. Megjithëkëtë sipas raporteve të fundit që e vlerësojnë zbatimin e saj dhe duke pasur parasysh atë që u doli në sipërfaqe gjatë takimeve konsultuese, në veçanti në komunën e Parteshit, ka një mungesë shqetësuese të zbatimit efektiv. Si pasojë, përparimi është i kufizuar, duke ofruar zgjidhje të pakët afatgjate dhe të qëndrueshme për nevojat dhe sfidat e ardhshme të personave të riatdhesuar.

Mungesa e vazhdueshme e zbatimit efektiv është pasojë e mungesës së përgjithshme të ndërgjegjësimit që çon në një ndarje plot rreziqe në mes përmbajtjes së politikës dhe zhvillimeve praktike në terren. Prandaj ekziston një kapacitet i dobët institucional i mishëruar nga një mungesë e qartë e transparencës, bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të mekanizmave institucional, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë komunal. Të gjithë këta faktorë së bashku me fonde të pamjaftueshme,[125] çojnë tek një ndihmë joefektive dhe tek mungesa e iniciativave që i adresojnë nevojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen personat e riatdhesuar.

Ky seksion e rishikon ndikimin e politikës dhe të zhvillimeve institucionale në mënyrë që të identifikohen dhe të shpjegohen arsyet kryesore të mungesës së zbatimit të kornizës së miratuar, si dhe sfidat pasuese në të cilat hasin institucionet dhe personat e riatdhesuar në Kosovë.

Faktorët kryesorë të gjetur, që kanë një ndikim negativ në zbatimin e kornizës së miratuar të politikës janë: mungesa e ndërgjegjësimit dhe e vullnetit politik, mungesa e transparencës, koordinimit dhe bashkëpunimit të pamjaftueshëm, një sistem jo i rregullt për mbledhjen e të dhënave, një identifikim i paefektshëm ose identifikim i vonuar i nevojave, dhe iniciativat e pakta të ndihmës.

[125] Këshilli i Sigurimit I Kombeve të Bashkuara, *Raporti I sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë,* gusht 2012.

1. Mungesa e ndërgjegjësimit

Ngritja e ndërgjegjësimit në mesin e institucioneve të rëndësishme qendrore, autoriteteve komunale, zyrtarëve dhe personave të riatdhesuar lidhur me masat ekzistuese për riintegrimin e personave të riatdhesuar, është një ushtrim thelbësor drejt një zbatimi efektiv. Megjithatë, anembanë Kosovës ka njohuri shumë të kufizuar mbi përmbajtjen e Strategjisë së rishikuar dhe Planit të veprimit. Ekziston , një nevojë e domosdoshme për udhëheqje dhe udhëzim.[126] Kjo u dëshmua në kornizën e takimit informativ publik të organizuar në qershorin e vitit 2013 nga ECMI Kosova në komunën e Parteshit, mes përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të riatdhesuarve të Parteshit, ku ishin të pranishëm përfaqësues të ZKKK-së të cilët deklaruan mungesën e informatave të duhura në lidhje me procesin e riintegrimit të të riatdhesuarve. Në ZKKK-në e Parteshit është raportuar se nuk ka asnjë zyrtar i ngarkuar që të punoj me të riatdhesuarit, siç kërkohet me Rregulloren për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim.[127] Në vend të zyrtarit të duhur një anëtar i Zyrës për integrime europiane i së njëjtës komunë ka mbuluar ad-hoc këtë pozitë.[128] Veçmas kësaj pyetjet kryesore të ngritura, nga të riatdhesuarit, gjatë takimeve të rëndësishme publike janë ndërlidhur me mungesën njohjes së qartë të të drejtave të tyre dhe me njohuri të pakta për shërbimet të cilat u takojnë atyre.[129] Vlerësimi dhe zbatimi i kornizës së politikës, që në qershor të vitit 2010, disa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për zhvillim të kapaciteteve janë zhvilluar aktivitete në nivel komunal në mënyrë që përmirësojnë hendekun e krijuar. Në dhjetor të vitit 2010 OSBE-ja botoi një broshurë për t'ju ofruar udhëzime zyrtarëve komunal mbi pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar,[130] dhe në korrik të vitit 2011, OSBE-ja kreu disa vizita në terren për të ndihmuar dhe për të vlerësuar mekanizmat operacionalë.

Sipas një raporti të OSBE-së të botuar në vitin 2011[131] që e vlerëson zbatimin e kornizës së politikës, që nga qershori i vitit 2010, në nivel komunal janë zhvilluar disa aktivitete mbi ngritjen e ndërgjegjësimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve, me qëllim që kjo çështje të përmirësohet.[132]

---

[126] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, *Raporti i takimit: Intervistë me Fahrije Tërnavën, drejtoreshë e Departamentit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e punëve të brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës,* 19 korrik 2013.

[127] Rregullorja nr. 02/2010

[128] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, Raporti i takimit*: Takimi publik në Partesh me njerëz të riatdhesuar*, 4 qershor 2013.

[129]Ibidem

[130]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Broshurë për zyrtarët komunalë mbi pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar,* dhjetor 2010, f. 27

[131]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011.

[132]Ibidem, f. 10

Andaj që nga viti 2010 janë bërë disa përmirësime në fushën e ndërgjegjësimit, udhëheqjes, udhëzimit për zbatimin e kornizës për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Në këtë drejtim zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim kanë treguar njohuri më të mira të rolit dhe përgjegjësive të tyre, dhe duke iu falënderuar sesioneve trajnuese mbi riatdhesimin dhe fondin e riintegrimit, të organizuara nga autoritetet e nivelit qendror, si Ministria e punëve të brendshme,[133] sot një numër në rritje i komunave ofron shërbime më të mira se disa vite më parë.

Megjithëkëtë, zyrtarët e lartë komunalë ende tregojnë shumë pak vetëdijesim dhe qartësi mbi instrumentet dhe procedurat ekzistuese,[134] dhe çka është më e rëndësishmja, personave të riatdhesuar ju mungon të kuptuarit e duhur të të drejtave të tyre, të shërbimeve që ju ofrohen dhe të procedurave që duhet t'i përdorin në mënyrë që të kenë qasje në ndihmën që u takon.[135]

Si pasojë, edhe pse njëfarë zhvillimi i vlefshëm është duke u bërë në nivel komunal, duhet siguruar një proces i ndërgjegjësimit të vazhdueshëm, udhëheqja dhe udhëzimi të jenë të pranishme në të gjitha nivelet me qëllim të arritjes së njohurive më të mira të përmbajtjes së kornizës mes institucioneve, për të përmirësuar dhe për të rritur ndihmën e dhënë, dhe për t'i bërë shërbimet dhe procedurat më të arritshme dhe më të kuptueshme për të gjithë.

2. Mungesa e transparencës dhe koordinimi i pamjaftueshëm dhe bashkëpunimi mes institucioneve

Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal është i domosdoshëm për t'i zbatuar në mënyrë efektive politikat dhe instrumentet ekzistuese që synojnë mbështetjen e riintegrimit të personave të riatdhesuar. Rrjedhimisht, mekanizmat koordinues të tillë *si Bordi koordinues ndërministror dhe Zyra për riintegrim* ndër të tjera janë përgjegjëse për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin dhe koordinimin e mandateve të të gjithë akterëve të përfshirë në procesin e ripranimit dhe të riintegrimit të personave të riatdhesuar.[136]

[133] Ibidem, faqet 10-11
[134] Ibidem, f. 11
[135] Qendra Europiane për çështje të minoriteteve, Raporti i takimit*: Takimi publik në Partesh me persona të riatdhesuar*, 4 qershor 2013.
[136] Shiko kapitullin 1 seksioni B

Siç është caktuar nga Strategjia e rishikuar dhe Plani i veprimit, zyrtarët e caktuar brenda ZKKK-ve janë përgjegjës për aktivitetet koordinuese që lidhen me riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe për t'i përcjellë këto informata drejt departamenteve të rëndësishme komunale.

Megjithëkëtë jo të gjitha komunat kanë një Zyrë për komunitete dhe kthim me zyrtarë që në mënyrë specifike janë përgjegjës për të riatdhesuarit.[137] Aty ku tashmë janë themeluar organet funksionale që ndërlidhen me riatdhesimin, shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi ndërmjet këtyre organeve dhe departamenteve të tjera të rëndësishme, në nivel komunal dhe atë qendror, është i parregullt ose praktikisht jo-ekzistues. Në disa raste këto organe nuk kanë kapacitet, burime dhe mbështetje politike për të realizuar detyra të tilla.

Në këtë kontekst është e nevojshme që të vendoset një komunikim i rregullt për të formalizuar sistemin e shkëmbimit të informatave midis atyre,që në kuadër të komunave, janë përgjegjës për procesin e riintegrimit dhe atyre në nivel qendror, si ata që ndodhen në ministritë e rëndësishme, që janë përgjegjës për trajtimin e çështjeve të të riatdhesuarve. Ashtu siç është raportuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë *"asnjë nga komunat nuk ka raportuar që të ketë marrë njoftim paraprak të mbërritjes së personave të riatdhesuar dhe prandaj asnjëra prej tyre nuk ishte në pozitë që ti bëj rregullimet e duhura lidhur me akomodimin tyre pas rikthimit".*[138]

3. Mbledhja e parregullt e të dhënave dhe koordinimi

Koordinimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave në nivel lokal, dhe në mes të nivelit qendror dhe atij lokal, ndërlidhen ngushtë me mirëmbajtjen e një baze të të dhënave dhe mbledhjen e të dhënave për ripranimin dhe për personat e riatdhesuar. Vendosja e mbledhjes së rregullt të të dhënave, të një bazë të besueshme të të dhënave dhe të një sistemi të përshtatshëm të vlerësimit të të dhënave, është një hap i domosdoshëm drejt realizimit efektiv të dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes së personave të riatdhesuar. Në këtë drejtim Zyrat komunale për komunitete dhe kthim janë përgjegjëse për mbajtjen e një bazë të dhënash që përmban të dhënat personale të gjithë personave të riatdhesuar të komunës. Përkatësisht zyra është përgjegjëse për koordinimin e këtyre informatave me ministritë përkatëse, në mënyrë që t'i mundësojë çdo organi përgjegjës që të planifikojë dhe të koordinojë ndihmën dhe aktivitetet e nevojshme të riintegrimit pas mbërritjes së të riatdhesuarve në fjalë. Në të njëjtën kohë

[137] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, *Raporti i takimit: Intervistë me Fahrije Tërnavën, drejtoreshë e Departamentit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës,* 19 korrik 2013.
[138] Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011, f. 23.

Ministria e punëve të brendshme (MPB) është përgjegjëse për koordinimin e të gjithë informatave të mbledhura, në mënyrë që të krijojë një bazë qendrore të të dhënave që përmban informata mbi të gjithë personat e riatdhesuar në Kosovë, në mënyrë që ajo të përdoret për nevoja të brendshme, për qëllime që ndërlidhen me riintegrim. Megjithatë gjetjet tregojnë se aktualisht ekziston një metodologji uniforme për mbledhjen e të dhënave, ruajtjen dhe shpërndarjen e tyre.[139]

Një shembull i mirë këtu është rasti i Zyrës për komunitete dhe kthim në Leposaviq ku në një fletore mbahen shënimet e të gjithë personave të cilët janë riatdhesuar në këtë komunë.[140] Për më tepër, të dhënat e mbledhura nuk janë në përputhje me krijimin e statistikave ose llojeve të tjera të të dhënave të përpunuara që mund të mbështesin planifikimin e aktiviteteve, projekteve apo nismave të ndryshme.[141] Për shembull Zyra komunale për komunitete dhe kthim në Partesh mban shënimet, për të gjithë personat e riatdhesuar në këtë komunë, në një dokument që nuk është i lidhur me bazën qendrore të të dhënave dhe informatat që përmban ky dokument nuk janë të sakta.[142]

4. Identifikimi joefikas apo i vonshëm i nevojave prioritare

Nga momenti kur të riatdhesuarit arrijnë në Kosovë komunat kanë mandat që të organizojmë ndihmën e nevojshme primare, sipas specifikave për çdo individ apo grup të të riatdhesuarve, të cilat vlerësohen përmes bazës së të dhënave të cilën komunat do të duhej ta krijonin, ruajnë dhe ta koordinojnë. Për më tepër, komunat duhet të vlerësojnë nevojat afatgjata të të riatdhesuarve me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve dhe projekteve adekuate të cilat mundësojnë zbatimin efektiv të politikave dhe Strategjisë së rishikuar.[143] Një ushtrim mbi vlerësimin e plotë të nevojave - është një hap thelbësor për zbatimin e politikave efektive. Megjithëkëtë, aktualisht asnjë nga komunat nuk ka kryer ndonjë vlerësim formal ose ka zhvilluar ndonjë program, strategji apo aktivitet e cila në nivel komunal synon të zbatojë masat e kornizës së politikave. Të gjitha aktivitetet ekzistuese të këtij lloji janë bërë përgjithësisht në mënyrë sporadike apo në baza ad-hoc.[144] Në këtë kontekst gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se në

[139] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, *Raporti i takimit: Intervistë me Fahrije Tërnavën, drejtoreshë e Departamentit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës,* 19 korrik 2013.
[140]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011, f. 13-14
[141]Ibidem, f. 14
[142] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, Raporti i takimit*: Takimi publik në Partesh me njerëz të riatdhesuar*, 4 qershor 2013.
[143]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 7
[144]Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - në Kosovë, *Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, shtator 2011, f. 14

rast të riatdhesimit të detyruar, të dhënat nuk janë në dispozicion dhe si pasojë e kësaj vlerësimi i nevojave dhe më pas ofrimi i ndihmës nuk lehtësohet në mënyrën e duhur.

5. Iniciativat e rralla të ndihmës

Strategjia e rishikuar dhe Plani i Veprimit vendosin që, pasi komunat të kenë kryer ushtrimin e vlerësimit të nevojave, nga autoritetet përkatëse duhet të ndërmerren masa konkrete në mënyrë që të adresohen nevojat dhe sfidat e njohura të të riatdhesuarve në fushat përkatëse të regjistrimit civil, arsimit, shëndetit, punësimit, mirëqenies sociale dhe të strehimit, të cilat do të financohen nga fondi qendror i ndarë për riintegrim. Megjithatë deri më sot komunat kanë bërë shumë pak për të zbatuar nisma në këtë drejtim.

5.1. Regjistrimi civil

Komunat janë përgjegjëse për ndërmarrjen e hapave që e lehtësojnë regjistrimin civil dhe dhënien e dokumenteve dhe certifikatave personave të riatdhesuar. Kjo do të përfshinte aktivitete të tilla si ofrimi i udhëheqjes për procedurën e regjistrimit civil përmes këshillave personale, shpërndarja e afisheve dhe fletushkave, apo duke bashkëpunuar me organizata dhe akterë të tjerë që punojnë me çështje të ngjashme me atë të riatdhesimit. Pavarësisht që disa komuna kanë zhvilluar nisma në këtë drejtim, në shumë raste ndihma nuk ka shënjestruar nevojat e veçanta të personave të riatdhesuar. Në mungesë të dokumentacionit personat e riatdhesuar janë parandaluar që të kthehen dhe/ose ti rikthejnë në posedim shtëpitë e tyre, si dhe u është mohuar qasja në të drejtat e tyre bazike duke përfshirë këtu punësimin, asistencën sociale, kujdesin shëndetësor dhe arsimimin[145]. Rrjedhimisht, regjistrimi civil dhe lëshimi i dokumenteve është një nga shqetësimet kryesore për personat e riatdhesuar dhe sidomos për ata të riatdhesuar që janë edhe pjesëtarë të komuniteteve pakicë.

5.2. Arsimi

Strategjia e rishikuar e përcjellë nga Plani i veprimit i siguron masat e projektuara për të lehtësuar riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor të Kosovës. Në këtë drejtim fëmijët e riatdhesuar trajtohen zakonisht në baza ad-hoc, rast pas rasti dhe në shumicën e komunave nuk ka programe ose masa enkas të destinuara për ti adresuar nevojat e tyre të veçanta të riintegrimit, të tilla si mbështetja gjuhësore, ose në realizimin e detyrave të shtëpisë përmes orëve shtesë në klasë. Si pasojë e kësaj braktisje të shkollës dhe nivelit të veçimeve në mesin e fëmijëve të riatdhesuar janë

[145]Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë*, f. 27

jashtëzakonisht të larta.[146] Megjithatë si pasojë e mungesës së të dhënave të sakta mbi numrin e të kthyerve dhe të fëmijëve të riatdhesuar [147] dhe si mungesë e vazhdimit të punës nga ZKKK-të dhe të DKA-ve mbi integrimin në shkollë të fëmijëve të riatdhesuar, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të caktuar gjendjen e kësaj situate.

5.3. Shëndetësia

Strategjia e rishikuar e përcjellë nga Plani i veprimit i siguron masat që synojnë ti ndihmojnë të riatdhesuarit pas pranimit nga ekipet mjekësore në aeroport[148] si dhe e lehtëson regjistrimin e personave të riatdhesuar në sistemin e shëndetësisë.

Në përgjithësi komunat kanë zhvilluar fushata promovuese të shërbimeve shëndetësore apo vizita në terren që për synim kanë popullatën e komunës dhe/ose komunitetet pakicë. Megjithatë ka mungesë të nismave të kujdesit shëndetësor për personat e riatdhesuar dhe nevojat e tyre specifike kanë tendencë që të adresohen në një bazë ad-hoc. Lidhur me këtë nuk janë zbatuar standardet minimale të kujdesit shëndetësor.[149]

5.4. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Një nga qëllimet kryesore të Strategjisë së rishikuar është të mundësoj riintegrimin e personave të riatdhesuar në aspektin socio-ekonomik duke u lehtësuar qasje në mundësitë e punësimit, në shërbimet ekzistuese sociale dhe mbështetjen e zhvillimit të biznesit.

Megjithatë ashtu si edhe në fushatë tjera të rëndësishme, edhe pse për një kohë të shkurtër mund të ofrohet një ndihmë në të ardhura, në nivel komunal nuk është ndërmarrë asnjë veprim specifik me qëllim të sigurimit të mundësive të qëndrueshme të punësimit afatgjatë. Andaj personat e riatdhesuar dhe nevojat e tyre të veçanta nuk janë duke u adresuar. Në këtë drejtim vetëm OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare siç është UNDP-ja[150]kanë zhvilluar disa projekte gjenerimi të të ardhurave për të siguruar një fokus/qasje të qëndrueshme në këtë fushë.

---

[146]Ibidem, f. 30

[147]Qendra Evropiane për çështje të Minoriteteve, *Doracak për Komunat: Përmirësimi i ofrimit të arsimimit për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë: Praktikat e mira dhe rekomandimet, tetor 2012, f. 46*

[148]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 7

Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: *Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë*, f. 35

[150] Projekti i Riintegrimit për punësim të qëndrueshëm i koordinuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) mars2012. Ndodhet në këtë vegzë: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/presscenter/articles/2012/03/07/almp-s-sustainable-employment-reintegration-of-repatriated-citizens-project.html (e konsultuar më 26 korrik 2013)

5.5. Strehimi

Shumë të riatdhesuar nga të gjitha etnitë ose e kanë të vështirë ose nuk janë në gjendje që të kthehen në shtëpitë e tyre të mëparshme. Andaj strehimi për personat e riatdhesuar mbetet një nga pengesat kryesore në procesin e tyre të riintegrimit. Duke iu referuar takimit informues publik të organizuar nga ECMI Kosova në Partesh çështjet e strehimit veçanërisht në lidhje me çështjet e dokumentacionit dhe të pronës, përbënin shumicën e shqetësimeve të ngritura gjatë takimit.[151] Për më tepër kjo është një çështje që është shpërfillur nga Strategjia e rishikuar dhe nga Plani i veprimit. Edhe pse disa komuna janë përpjekur që përmes strehimoreve, strehimit tek familjarët, apo përmes kampeve të personave të zhvendosur, të gjejnë zgjidhje të përkohshme për sfidat e strehimit me të cilat përballen personat e riatdhesuar, ende nuk ka ndonjë zgjidhje të qëndrueshme. Për më tepër edhe përkundër Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,[152] fondi për rindërtimin e shtëpive [153] dhe skema e menaxhuar nga Agjencia kosovare e pronës[154] komunat nuk kanë bërë një shfrytëzim të qëndrueshëm dhe të rregullt të kësaj kornize për ti dhënë ndihmë personave të riatdhesuar. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të theksohet se nëse të riatdhesuarve nuk u garantohet e drejta e tyre për strehim të përshtatshëm, ata rrezikojnë të shndërrohen në persona e status të përhershëm të të zhvendosurve brenda vendit.

[151] Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve, Raporti i takimit*: Takimi publik në Partesh me persona të riatdhesuar*, 4 qershor 2013.
[152]*Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar,* maj 2010, f. 29
[153]Ibidem
[154] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010*, f. 31

Konkluzionet

Korniza rregullative drejtuese e procesit të riatdhesimit ka qenë prej kohësh e paqëndrueshme. Mirëpo pritet që instrumentet e reja të zbatohen në një mënyrë serioze për të siguruar një proces më efikas dhe me ndikimin më të mirë për përfituesit. Kapaciteti i kufizuar i autoriteteve ka ndikuar në zbatim. Për shembull deri më tani asnjë komunë nuk ka bërë një vlerësim formal ose ka zhvilluar ndonjë program, strategji apo aktivitet që në nivel komunal synon të zbatojë masat e kornizës së politikave.

Ky është kryesisht rezultat i **përgjegjësive të paqarta** ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal. Një faktor tjetër që e pengon kornizën është se para riatdhesimit shumë kanë shpresa të larta, gjë që i zhgënjen ata kur pas kthimit ndeshen me standardet.

Për të përmirësuar këtë është thelbësore **që në të gjitha nivelet të sigurohet udhëheqja dhe udhëzimet** për të fituar njohuri më të mirë të përmbajtjes së kornizës në mesin e institucioneve në mënyrë që ato të jenë në gjendje që t'i shpërndajnë informatat e duhura. Kjo përfundimisht do të përmirësojë ndihmën në dispozicion dhe do të rrisë ndërgjegjësimin tek ata që i qasen sistemit. Për më tepër, kjo do ti bëjë shërbimet dhe procedurat më të arritshme dhe të kuptueshme për të gjithë.

Aktualisht, nuk ekziston asnjë lidhje **në mes të MPB-së, institucioni bartëse e procesit të riatdhesimit, dhe sistemeve të tjera, të tilla si MKK-ja bartëse e procesit të kthimit**. Nëpërmjet komunikimit, ato do të ishin në gjendje të shkëmbejnë konceptet për praktikat e mira, duke rritur njohuritë dhe efektivitetin. Për më tepër, një transparence e rritur dhe një shkëmbim i informacionit **midis nivelit lokal dhe qendror** është i domosdoshëm për të promovuar efikasitetin. Disa çështje kyçe mbeten shqetësim për personat e riatdhesuar. Për shembull, regjistrimi civil dhe lëshimi i dokumenteve mund të jetë çështje problematike për personat e riatdhesuar. Përveç kësaj, **braktisja e shkollës** dhe normat e segregacionit dhe/apo veçimit në shkolla në mesin e fëmijëve të riatdhesuar janë jashtëzakonisht të larta, duke demonstruar nevojën jetike për ngritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me këtë situatë. Rekomandohet që qeveria të zhvillojë projekte që gjenerojnë të ardhura për të favorizuar riintegrimin e qëndrueshëm me shpresën e përmirësimit të procesit të riatdhesimit dhe rritjes së efikasitetit. Nëpërmjet transparencës më të madhe, bashkëpunimit dhe ndërgjegjësimit, procesi i riatdhesimit mund të bëhet më efikas.

Bibliografia

Raportet

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2012.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) - Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë (Kosovë), Vështrim Statistikor: Përditësuar në fund të shtatorit 2010.

Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), E drejta ndërkombëtare e Migrimit: Fjalor për Migrimin, 2004.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Fjalor i specializuar i termave 2006.

Qendra e dokumentimit të refugjatëve në Irlandë, Kosova: Trajtimi të kthyerve në Kosovë pas shumë viteve të kaluara në vende të tjera, 2011.

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI), Raport: Grupi punues për romë, ashkali dhe egjiptian. Procesi i riatdhesimit dhe lagjja Kristal, 30 prill 2013.

Këshilli i sigurimit të kombeve të bashkuara (KSKB), Raport i Sekretarit të përgjithshëm për Misionin e administratës së përkohshme të kombeve të bashkuara në Kosovë, gusht 2012.

Human Rights Watch, Raporti Botëror 2013: Kosova, janar 2013.

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë, Broshurë për zyrtarët komunalë mbi pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar, dhjetor 2010.

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë, Një vlerësim mbi procesin e kthimit vullnetar në Kosovë, tetor 2012.

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë, Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, shtator 2011.

Amnesty International (AI), Jo gjithkund të mirëseardhur: Ndaloni kthimin e detyruar të romëve në Kosovë, 2010.

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE), Departamenti për të drejtat e njeriut, decentralizim dhe komunitete - Misioni në Kosovë, Tetë vjet më pas kthimit të minoriteteve dhe rikthimit të shtëpive dhe pronave në Kosovë, qershor 2007.

Departamenti për të drejtat e njeriut, decentralizim dhe komunitete, Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë, Planifikimi dhe implementimi i Strategjisë Komunale për Kthim në komunat e Kosovës, prill - maj 2007.

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE), Departamenti për të drejtat e njeriut, decentralizim dhe komunitete - Misioni në Kosovë, Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës, nëntor 2009.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Doracak për riatdhesimin dhe aktivitetet e riintegrimit, maj 2004.

Human Rights Watch (HRW), Të drejtat e të Zhvendosurve: Kthimet e detyruara të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve nga vendet e Europës perëndimore në Kosovë, 2010.

Misioni i përkohshëm i administratës së kombeve të bashkuara në Kosovë (UNMIK), Dokumenti për riatdhesimin e shqiptarëve të Kosovës, tetor 2000.

Instrumentet

Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013.

Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i veprimit: Zbatimi i strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010.

Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj 2010.

Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja nr 02/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKT-të), shkurt 2010.

Qeveria e Republikës së Kosovës - Grupi punues ndërministror, Termat e referencës për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, prill 2011.

Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 10/2012 për Menaxhimin e programit, organeve kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2012.

Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, gusht 2010.

ECMI Kosova

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë (ECMI), Raporti: Takim i hapur me persona të riatdhesuar në komunën e Parteshit, 4 qershor 2013.

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë (ECMI), Raport: Intervistë me zonjën Fahrije Tërnava, Drejtor i Departamentit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e punëve të brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, 19 korrik 2013.

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë (ECMI), Manual për zyrtarët komunal: Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian: Praktikat e mira dhe rekomandimet, tetor 2012.

Ueb faqet

Mandati i Administratës së përkohshëm të OKB-së në Kosovë (UNMIK), në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/Pages/about.aspx (konsultuar më 26 korrik 2013)

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Një përditësim për krizën e Kosovës 1999-2000, në dispozicion në: http://www.unhcr.org/3ae6b80f2c.html (konsultuar më 26 korrik 2013)

Projekti për punësimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin i koordinuar nga Programi për zhvillim i kombeve të bashkuara (UNDP), në partneritet me Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS) dhe Ministrinë e punëve të brendshme (MPB), mars 2012. Mund të gjendet në: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/presscenter/articles/2012/03/07/almp-s-sustainable-employment-reintegration-of-repatriated-citizens-project.html (konsultuar më 26 korrik 2013)

Aneksi - Korniza Ligjore dhe Instrumentet Ndërkombëtare[155]

1. Dokumentet referuese të Republikës së Kosovës në fushën e riintegrimit, Republika e Kosovës ka një bazë të gjerë ligjore, ku si legjislacion parësor mund të përmendet, por duke mos u kufizuar vetëm në:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
Ligji për shtetësinë;
Ligji për azilin (Nr 03/L-066);
Ligji për të huajt (Nr 03/L-126);
Ligji për punësimin e të huajve;
Ligji për librat amzë;
Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin;
Ligji për emrin personal;
Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale;
Ligji për letërnjoftim;
Ligji për dokumentet e udhëtimit;
Ligji për azilin;
Ligjin mbi pronën;
Ligji për regjistrat e gjendjes civile;
Për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës;
Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale;
Ligji për regjistrimin e popullsisë dhe banesave në Kosovë;
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
Ligji për kujdesin shëndetësor emergjent;
Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi;
Ligji mbi pensionin bazë;
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 mbi Skemën e ndihmës sociale në Kosovë;
Projektligji i Punës;
Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre;
Kodi Penal i Kosovës;
Kodi i Procedurës Penale;
Ligji për pensionet invalidore;
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
Ligji për Familjen;
Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare;
Ligji mbi edukimin parashkollor;
Ligji për shëndetin publik;
Ligji për Mërgatën e Kosovës;
Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm;
Ligji për inspektimin e arsimit në Kosovë;
Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës;
Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional;
Udhëzimi Administrativ nr. 2004/11 për punën dhe kriteret për vendosjen e banorëve në shtëpi e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare;
Udhëzimi Administrativ nr 12/2004 për punën dhe vendosjen e banorëve në Institucionin special në Shtime;
Strategjia kombëtare për migracionin;
Strategjia kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

[155] *Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, maj* 2010,

Strategjia kombëtare për shëndetësinë;
Strategjia për parandalimin e incidenteve në shkolla.

2. Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, të cilat ndikojnë në mbrojtjen e personave të riintegruar janë:

1. Deklarata universale për të drejtat e njeriut;

2. Konventa e Gjenevës për Mbrojtjen e Refugjatëve, 1951, dhe Protokolli, 1967;

3. Konventa e New York-ut për personat pa shtetësi;

4. Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas;

5. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese apo ndëshkimit, 1984;

6. Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe Protokollet e saj;

7. Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijës;

8. Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike dhe Protokollet e saj.